




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
DREJTORIA E KURRIKULAVE, SIGURIMIT TË CILËSISË
DHE KËRKIMIT SHKENCOR
SEKTORI I KURRIKULAVE DHE SIGURIMIT TË CILËSISË

Korçë, më 27/11/2020


RAPORT I PYETËSORIT PËR MËSIMIN ONLINE NËNTOR 2020

Në kuadër të mbarëvajtjes së procesit të mësimit nëpërmjet platformave "ONLINE" Sektori Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë, ka përgatitur pyetësin për mësimin ONLINE, i cili është një pyetësor paraprak që iu është dërguar një numri të kufizuar studentësh për të nxjerrë problematikat e mësimit online; pas kësaj do të rishpërndahet për të gjithë studentët.

-Pyetësi u plotësua nga 53 studentë, 3 prej të cilëve ishin nga Fakulteti i Bujqësisë, 9 nga Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, 16 nga Fakulteti i Ekonomisë dhe 23 nga Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane.



Për sa i përket programit të studimit 8 ishin program 2-vjecar profesional, 36 bachelor dhe 9 master, përkatësisht 17 në vit të parë, 25 në vit të dytë, 11 në vit të tretë.




Pothuajse 99% e studentëve pjesëmarrës janë përgjigjur që mësimi online është zhvilluar rregullisht, me disa problematika kryesisht në ditët e para të mësimit online.

Vështirësitë dhe probleme të hasura

62% e studentëve pjesëmarrës kanë hasur problematika ose vështirësi të ndryshme, ndër të cilat, më poshtë gjenden të listuara më kryesoret dhe më të përmendurat:

1. Si problematikë kryesore më e përmendur dhe më e hasur nga 21% e studentëve pjesëmarrës është cilësuar njohja dhe hyrja në platformë sidomos në ditët e para deri sa studentët janë përshtatur dhe kanë mësuar si ta përdorin.
2. E dyta mund të renditet problemi i lidhjes me internet dhe shkak kryesor shkëputjen e zërit për shkak të cilësisë së internetit të secilit student, gjë e cila ka ndikuar edhe në kuptueshmërinë jo të saktë të asaj çka komunikohet, po ashtu jo të gjithë studentët kanë pasur mundësi të kenë akses në internet, problematikë kjo e pranishme në nivelin 19%.
3. Tjetër problematikë janë pajisjet që studentët përdorin, ku jo të gjithë mundën të kenë kompjuter desktop apo laptop cilësor apo telefon smart që të mundën ta përdorin lehtësisht platformën, kjo problematikë është listuar nga 5% e studentëve pjesëmarrës
4. Mungesa e njoftimeve është cilësuar si problematikë në disa raste (5% e studentëve), për shembull njoftimi për fillimin e mësimit dhe mënyrën e përfshirjes në klasat online.
5. Mësimi online në përgjithësi është cilësuar prej rreth 5% e studentëve si jo i arritshëm ose efektiv njësoj si në auditor
6. Po ashtu studentët me emra dhe mbiemra të njëjtë apo të ngjashëm kanë pasur problem kur janë përzgjedhur nga pedagogët në krijimet e grupeve, 2% e tyre janë futur në grupet e gabuara



Si probleme konkrete të hasura studentët listojnë kryesisht hyrjen në platformë, dhe aksesimin e internetit dhe më pas mungesa e pajisjeve, mungesa e informimit etj.

Lëndë të pazhvilluara

35% e studentëve janë përgjigjur se në disa prej lëndëve nuk kanë zhvilluar ende mësim dhe i kanë listuar ato si më poshtë:


- Arte figurative dhe arte skenike
- Arti i kinetikës dhe metodologji loje
- Edukimi muzikor
- Laborator për formimin profesional
- Projektimi, dokumentimi dhe vlerësimi
- Psikopatologjia e zhvillimit
- Sociologji e organizatave
- Psikologji sociale
- Informatike
- Arkeologji
- Anglisht
- Kontabilitet financiar
- Matematikë e zbatuar
- Bazat kulturore te edukimit

Pavarësisht lëndëve të listuara, mund të themi se disa prej tyre nuk janë realizuar për çështje teknike pasi realizimi i tyre online është i vështirë për shkak të formës së shpjegimit si edhe lëndët praktike dhe laboratorike. Nga ana tjetër një pjesë e mirë e lëndëve jepen nga pedagogë të jashtëm të cilët nuk kanë akses në platformën OFFICE 365.

Për sa i përket vlerësimit të procesit online nga 1 deri në 5, ku 1 tregon pikën më të dobët dhe 5 pikën më të fortë, vlerësimi total ka qenë në një nivel mesatar prej 2.92.

Shprehur në përqindje:

17% kanë dhënë vlerësimin 5
17% kanë dhënë vlerësimin 4
32% kanë dhënë vlerësimin 3
9.5% kanë dhënë vlerësimin 2
24.5% kanë dhënë vlerësimin 1



MENDIME

Rreth 17% e studentëve kanë dhënë një mendim ose koment shtesë rreth pyetjeve më sipër, të cilat gjenden më poshtë:

9% e tyre janë shprehur se janë të pa kënaqur me mungesën e internetit ose të valëve për shkak të destinacionit ku jetojnë, ose të teknologjisë sepse në familje janë disa persona që zhvillojnë mësim online e nuk kanë si ti ndajnë pajisjet. Mësimi online është cilësuar si jo efikas ose platforma e pa përdorur më parë, po ashtu disa janë shprehur se mësimi online është pak i vështirë sidomos në shkencat ekzakte dhe në degën Matematikë.

Por rreth 8% e tyre kanë dhënë edhe mendime dhe komente pozitive, sipas të cilave është treguar interes dhe përkushtim si nga ana e stafit akademik dhe nga studentet, stafi është shumë i përgatitur, përkushtimi i pedagogëve dhe universitetit është maksimal, megjithatë mësimi online është në vetvete problematik.

Një pjesë e mirë e tyre kërkojnë të kthehen sa më parë në auditorë.

REKOMANDIME NGA STUDENTË:

11% e studentëve kanë dhënë rekomandimet e tyre rreth pyetjeve më sipër ose rreth zgjidhjeve të mundshme për problematikat e listuara, ata janë shprehur se:

Nëse mund të gjendej një zgjedhje ku për një javë të bëhej mësim online dhe javën tjetër në auditor do të ishte shumë më mire sidomos për lëndët matematikë, fizikë, biologji-kimi etj.

Pedagogët të shkojnë në shkollë dhe ta shpjegojnë mësimin sikur të ishin në klasë

Të zhvillosh mësim online në një platformë jo të njohur është pak e vështirë për studentët, por të bësh mësim online për lëndët shkencore është akoma më e vështirë

Duhet të kryhet një alternim ndërmjet mësimit online për sa i përket leksioneve ose seminareve dhe kryerjes së praktikës

Përdorimi i videocall-it mund të zëvendësohet me një metodë tjetër

Në lidhje me mësimin online nuk janë dakord, sidomos programi i studimit Biologji - Kimi pasi është një degë shkencore e cila ka nevojë për pjesëmarrje dhe mësimdhënie më të zhvilluar, sidomos në shkencat ekzakte siç janë matematika, fizika apo kimia ku ka gjithmonë ushtrime dhe ka nevojë për shumë shpjegime dhe koha online jo vetëm që nuk mjafton por nuk jep dhe rezultate të mira.

Zhvillimin qoftë vetëm të seminareve në auditor

PËRFUNDIME DHE SUGJERIME

Qëllimi i zhvillimit të këtij pyetësi i trajtuar që në hyrje të tij synon nxjerrjen e problemeve gjatë mësimit online në mënyrë që të merren masat për përmirësim nga njësitë kryesore dhe njësitë bazë.

- *Lidhur me lëndët e pazhvilluara të përmendura nga studentët (që mund të jenë zgjidhur nga njësitë bazë) sugjerohet të verifikohen edhe një herë nga njësitë bazë në mënyrë që mësimi të realizohet i plotë.*
- *Lidhur me zhvillimin e mësimit online nga pedagogët e jashtëm për shkak se këta të fundit nuk kanë akses në platformën OFFICE 365, mësimin mund ta zhvillojnë nëpërmjet platformave të tjera (G-Classroom, G-Meet etj).*
- *Si model efektiv sugjerohet pajisja e mjediseve të UK sidomos Laboratorët me pajisje për mësim online në mënyrë që studentët të ndihen si pjesë e auditorit dhe të përvetësojnë më lehtë sidomos lëndët që kërkojnë shpjegim konkret në tabelë.*

Megjithëse pyetësi u zhvillua vetëm në një pjesë të studentëve për të marrë mendimet e tyre paraprake, nga përgjigjet e tyre kuptojmë se mësimi online është zhvilluar por me disa problematika sidomos në përdorimin e platformës ose në shpjegimin e lëndëve ekzakte si edhe në arritjen e internetit apo pajisjeve të përdorura, një pjesë e problematikave janë zgjidhur.

Mendimet përfundimtare të studentëve janë që pavarësisht angazhimeve mësimi online është zgjidhje e përkohshme por jo aq efektive sa mësimi në auditor.

Pyetësi do të realizohet sërish në një numër më të madh studentësh për të marrë edhe më shumë përgjigje apo për të kuptuar më tepër rreth problematikave të cilat kërkojnë zgjidhje.

Sektori Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë

Evis Kapurani

